

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7047
E martë, 14 nëntor 2023
Çmimi 0.50

Mbi 1 350 qytetarë
në veri kanë
reregjistruar veturat
me targa RKS FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN:
SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (8)

NËSE DO TË KISHTE ÇMIM NOBEL PËR LIRI, FAMILJA JASHARI E PREKAZIT DO TË DUHEJ TA MERRTE!

- Nëse do të kishte çmim
Nobel për liri, familja Jashari e
Prekazit do të duhej ta merrte!
Bernard Kouchner



Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së tetë, ka theksuar se përfundimi i luftës na gjeti në një gjendje tejet të rëndë. Ai ka

kujtuar një takim me Rifat Jasharin në një odë të vogël që kishte mbetur e parrënuar nga kullat e Jasharëve në Prekaz, ku ishin të pranishëm edhe komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, Jetullah Geci, Bashkim Jashari,

Gani Koci etj., dhe gjatë këtij takimi Bernard Kouchneri i tha Rifat Jasharit: "Nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja juaj do të duhej ta merrte!", sepse pikërisht nga sakrificat e mëdha në Prekaz bota e kuptoi realitetin e kësaj lufte!

KMDLNJ-JA: KA MUNGESË TË TRANSPARENCËS NË DIALOG NGA KURTI, OPOZITA ËSHTË BËRË KONTRIBUUESE E TERRIT INFORMATIV



Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se bisedimet me Serbinë kanë hyrë në fazën e një transparence të munguar nga kryeministri Albin Kurti dhe vartësit e tij. Sipas KMDLNj-së, kryeministri Albin Kurti para deputetëve dhe qytetarëve, me një retorikë manipulative vetëm sa e bën më të errët

dhe më të panjohur dokumentin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që po qarkullon në opinion. KMDLNj-ja ka theksuar se është sa befasuese aq dhe e papranueshme që edhe opozita është bërë kontribuuese e territorit informativ pas takimit që kishte me Lajçakun në Prishtinë

AKTUALE



CAMERONI EMËROHET SEKRETAR I
JASHTËM I BRITANISË **F. 2**

MOLLIQAJ: DRAFTI I ASOCIACIONIT
QË QEVERIA E PRANOI CODET NË
THELB REPUBLIKËN E KOSOVËS **F. 3**

KROACIA TRAJNON POLICINË
USHTARAKE TË FSK-së **F. 7**

EKONOMI



RRITEN ÇMIMET, RËNDOHET
PËR 3.3 % MË SHUMË
SHPORTA E QYTETARIT **F. 8**

INSPEKTORATIT TË PUNËS
I SHTOHEM EDHE 19 INSPEKTORË **F. 8**

SPORT



BALLKANI I PAGABUESHËM
NDAJ DUKAGJINIT **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Cameroni emërohet sekretar i Jashtëm i Britanisë

LONDËR, 13 NËNTOR - Ish-kryeministri i Britanisë, David Cameron, është emëruar në pozitën e sekretarit të Jashtëm, pasi kryeministri britanik Rishi Sunak riformatoi qeverinë. Cameron, 57 vjeç, që ka qenë kryeministër nga 2010 deri më 2016, ka dhënë dorëheqje pas rezultatit të referendumit që çoi në largimin e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. Zyra e Sunakut tha më 13 nëntor se Mbreti Charles ka miratuar kërkesën që Cameronit t'i jepet ulëse në Dhomën e Lartë të Parlamentit, duke i lejuar të

kthehet në qeveri si ministër, pavarësisht se nuk është zgjedhur anëtar i Parlamentit. Më herët gjatë ditës, Sunak shkarkoi Suella Braverman nga pozita e sekretares së Brendshme. Ajo u përball me kritika pasi akuzoi policinë se ishte shumë e butë para protestuesve pro-palestinezë. Në pozitën e sekretarit të Brendshëm u emërua James Cleverly, i cili deri më tani ka qenë sekretar i Jashtëm. Sunak është përballur me presion që ta shkarkojë Braverman, e cila ishte përgjegjëse për migrimin

dhe policinë. Në një sulm të pazakonshëm ndaj policisë javën e kaluar, Braverman tha se policia e Londrës po injoronte "bandat pro-palestineze" që po shkelnin ligjin. Ajo i përshkroi protestuesit që bënin thirrje për armëpushim në Gazë si "marshues të urrejtjes". Të shtunën protestuesit e krahut të djathtë u përleshën me policinë dhe tentuan të përlesheshin me protestuesit pro-palestinezë në Londër. Kritikët thanë se Braverman ka ndihmuar në nxitjen e tensioneve.



Këshilli i Evropës: Marrëveshja Shqipëri - Itali rrit shqetësimet për shkeljet e të drejtave të njeriut



BRUKSEL, 13 NËNTOR - Komisionarja e lartë për të drejtat e njeriut në Këshillin e Evropës, Dunja Mijatović, tha se marrëveshja e arritur në mes të Shqipërisë dhe Italisë për emigrantët rrit shqetësimet për të drejtat e njeriut dhe shton shqetësimet për trendin evropian që përgjegjësitë për azilkërkuessit të dalin jashtë kornizës evropiane. "Memorandumi i mirëkuptimit ngre një sërë pyetjesh të rëndësishme mbi ndikimin që mund të ketë zbatimi i tij ndaj të drejtave të refugjatëve, azilkërkuessve dhe emigrantëve. Memorandumi krijon një regjim ad hoc azili ekstraterritorial, të karakterizuar nga shumë dykuptimësi ligjore. Në praktikë, mungesa e sigurisë ligjore ka të ngjarë t'i minojë masat mbrojtëse për të drejtat e njeriut dhe përgjegjësinë për shkeljen e

rregullave, duke rezultuar në trajtim diferencial në mes të atyre që aplikimet për azil do të shqyrtohen në Shqipëri dhe atyre që do të shqyrtohen në Itali", tha ajo. Mijatović tha se ky memorandum është një tregues i një dëshire të shfaqur edhe në shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Evropës, të cilët po shqyrtojnë modele të ndryshme për azilkërkuessit si "zgjidhje të shpejtë" të sfidave të ndërlikuara që paraqet ardhja e refugjatëve, azilkërkuessve dhe emigrantëve. "Megjithatë, këto masa rritin në mënyrë të ndejshme rrezikun për t'i ekspozuar refugjatët, azilkërkuessit dhe emigrantët ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Bartja e përgjegjësisë përtej kufijve nga disa shtete stimulon shtetet e tjera që të veprojnë njësojë, gjë që rrezikon të krijojë një efekt domino që do ta

minonte sistemin evropian dhe botëror për mbrojtje ndërkombëtare", tha Mijatović. Më 6 nëntor kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe ajo e Italisë, Giorgia Meloni, nënshkruan marrëveshje, sipas së cilës, Italia do t'i dërgojë në Shqipëri emigrantët që shpëton në Detin Mesdhe, ndërsa Italia do të financojë për ngritjen e qendrave për pritjen e tyre. Marrëveshja do të nisë së zbatuari në pranverën e vitit të ardhshëm. Sipas protokollit të publikuar nga qeveria shqiptare, Italia do të depozitojë 16.5 milionë euro në një llogari të posaçme të Thesarit të Shqipërisë si paradhënie për strehimin e emigrantëve. Marrëveshja është kritikuar nga Organizata për të Drejtat e Njeriut "Amnesty International", që e ka quajtur atë "të jashtëligjshme dhe të pazbatueshme".

Evakuohen shqiptarët e parë nga Gaza

GAZA, 13 NËNTOR - Autoritetet në Shqipëri njoftuan se një grua shqiptare me katër fëmijët e saj të mitur janë evakuuar nga Rripi i Gazës dhe do të udhëtojnë drejt Shqipërisë. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, tha se për nxjerrjen e tyre nga Gaza e rrethuar u deshën tri javë përpjekje përderisa lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit - organizatë e shpallur terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - po vazhdon në Gazë. "Mirënjohje për autoritetet e Izraelit dhe Egjiptit dhe ambasadave shqiptare në dy shtetet për punën e mirë në këtë situatë dhe operacion kompleks", tha Hasani. Nëna dhe katër fëmijët e saj ndodhen në Egjipt dhe po vijojnë procedurat që të dërgohen drejt Shqipërisë. Burimet bëjnë me dije

se gruaja nuk ka pasaportë shqiptare, por emri i saj figuron në regjistrat e gjendjes civile në Shqipëri. Ajo ka baba palestinez dhe nënë shqiptare. Babai i saj ka qenë student në Shqipëri në vitet '70 dhe pas martesës, bashkë me bashkëshorten e tij, janë zhvendosur në territoret palestineze. Mësohet se bashkëshorti i shqiptares së evakuuar është palestinez dhe ka qenë e pamundur të largohet nga Gaza pasi nuk është lejuar nga autoritetet. Ministria e Jashtme e Shqipërisë tha se po punohet për kthimin e shpejtë dhe të sigurt të shtetasve të tjerë që ndodhen në Gazë. Mes tyre është edhe vëllai i gruas që u evakuua nga Gaza, bashkë me familjen.



KMDLNj-ja: Ka mungesë të transparencës në dialog nga Kurti, opozita është bërë kontribuuese e territ informativ

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se bisedimet me Serbinë kanë hyrë në fazën e një transparence të munguar nga kryeministri Albin Kurti dhe vartësit e tij. Sipas KMDLNj-së, kryeministri Albin Kurti para deputetëve dhe qytetarëve, me një retorikë manipulative vetëm sa e bën më të errët dhe më të panjohur dokumentin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që po qarkullon në opinion. KMDLNj-ja ka theksuar se është sa befasuese aq dhe e papranueshme që edhe opozita është bërë kontribuuese e territ informativ pas takimit që kishte me Lajçakun në Prishtinë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar të hënën se bisedimet me Serbinë kanë hyrë në fazën e një transparence të munguar nga kryeministri Albin Kurti dhe vartësit e tij. Sipas KMDLNj-së, qytetarët po dezinformohen kryesisht nga mediet vendore dhe ato ndërkombëtare për zhvillimet që janë përcaktuese për fatin e tyre. "Në emër të ruajtjes së konfidencialitetit që të mos dëmtohet procesi, politikanët vendorë (një numër i vogël i tyre) u shesin mjegull qytetarëve të Kosovës duke i lënë në terr informativ dhe duke ngritur spekulime të ndryshme (në mungesë të informatave janë të arsyeshme) sidomos për Asociacionin e komunave serbe që në mënyrë ultimative po kërkojnë ndërkombëtarët të formohet. Në veçanti ka zgjuar kureshtje propozimi i pesëshes ndërkombëtare që i lanë kryeministrit të Kosovës mbi tavolinë pa zbuluar fare përmbajtjen apo duke bërë përpjekje ta mbështjellin me një mbështjellës kushtetues e që as për së afërmi i plotëson nevojat e qytetarëve për t'u informuar për këto zhvillime",

është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, kryeministri Albin Kurti para deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe qytetarëve, me një retorikë manipulative vetëm sa e bën më të errët dhe më të panjohur këtë dokument. "Ndërkaq, ambasadorët që vrapojnë e kthjellin në Kosovës 'sigurojnë' se ky propozim qenka në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës duke bërë presion, në anën tjetër që i njëjti mos të bëhet publik deri në një moment të përshtatshëm. E drejta për t'u informuar është e drejtë elementare e njeriut kurse të zgjedhurit e popullit apo të emëruarit kanë detyrim ligjor të jenë transparent dhe llogaridhënës e që nuk po e bëjnë, as të parën e as të dytën. Për KMDLNj-në është sa befasuese aq edhe e papranueshme që edhe opozita është bërë kontribuuese e territ informativ pas takimit që kishin me Lajçakun në Prishtinë në vend se të këmbëngulë që kryeministrit i Kosovës të mos e lëshojë sallën e Kuvendit pa e treguar përmbajtjen e propozimit", është thënë në këtë reagim të KMDLNj-së, duke shtuar se: "Në opinion doli një version jozyrtar i propozimit e që ngjalli shumë dilema dhe



pakënaqësi. Për faktin se ky propozim po mbahet larg syve të opinionit publik lë të kuptohet se gjërat nuk janë ashtu si deklarohen dhe se po bëhen përpjekje të blihet kohë duke përdorur në ndërkohë mjete për ta relativizuar këtë pakënaqësi. KMDLNj e përkujton opinionin se të gjithë akterët politikë dhe jopolitikë që janë pjesë e këtij territori informativ në mënyrë flagrante po i shkelin të drejtat e njeriut dhe se do t'i bartin pasojat elektorale por edhe ligjore në një kohë të përshtatshme". Sipas KMDLNj-së, me fshehjen e informatave që janë me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët e Kosovës në mënyrë të vetëdijshme apo nën një kërcënim nga ndërkombëtarët ata po kontribuojnë në përshkallëzim të situatës së sigurisë për faktin se mund dhe do të ketë kundërshtim të organizuar të qytetarëve sikur që na mëson e kaluara. Pasojat e këtij përshkallëzimi pa asnjë dyshim do t'i bartin "kalorësit e territ informativ". "Ndërkombëtarët, që nga

fillimi kanë deklaruar se transparencja dhe llogaridhënia janë pjesë e rëndësishme dhe e pazëvendësueshme e vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut ndërsa tani, për shkak të një oportuniteti politik e kanë futur kokën në rërë, madje po bëjnë presion mbi klasën e paemancipuar mjaftueshëm politikisht të Kosovës", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka publikuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që është propozuar nga pesë emisarë të BE-së dhe të ShBA-së. Ky dokument i jep mundësi Serbisë të funksionojë brenda Kosovës. E për vërtetësinë e këtij dokumenti, nga Bashkimi Evropian kanë mohuar se dokumenti i tyre është bërë publik. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, në një përgjigje me shkrim për "Telegraf"-in, ka thënë se asnjë dokument i kësaj natyre nuk është bërë publik. "Propozimi i BE-së nuk është bërë publik pasi

përpjekjet diplomatike janë duke vazhduar. Ne kurrë nuk kalojmë dokumente zyrtare që diskutohen dhe presim të njëjtën gjë nga partnerët, pasi është praktikë normale në ndërmjetësimin ndërkombëtar që procesi të zhvillohet në konfidencialitet. Është, gjithashtu, politikë jona që të mos komentojmë rrjedhjet e supozuara ose raportet e medieve që pretendojnë se e kanë parë ose publikuar dokumentin", ka thënë Stano. Miroslav Lajçak udhëhoqi një grup emisarësh perëndimorë në një vizitë në Prishtinë dhe Beograd më 21 tetor, duke i paraqitur Kosovës dhe Serbisë një draft-statut për Asociacionin. Megjithatë, përmbajtja e këtij statuti nuk është bërë publike deri më tani. Kryeministri Kurti ka shprehur gatishmërinë e tij për ta pranuar dhe nënshkruar draft-statutin për krijimin e Asociacionit, ndërsa presidenti serb Aleksandër Vuçiq ka përsëritur qëndrimin e tij se nuk do të pranohet asnjë dokument që përfshin njohjen de facto të Kosovës.

Molliqaj: Drafti i Asociacionit që qeveria e pranoi godet në thelb Republikën e Kosovës



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Aktivistët e Partisë Socialdemokrate kanë mbajtur të hënën një aksion para Qeverisë së Kosovës, duke kundërshtuar draft-statutin për Asociacionin. Aktivistët kanë zëvendësuar flamurin e Kosovës me një improvizim të një flamuri me dy yje dhe një pjesë e territorit me ngjyrë të bardhë. Kryetari i kësaj partie, Dardan Molliqaj, ka thënë se drafti i Asociacionit që qeveria e pranoi e godet në thelb Republikën e Kosovës. "Si akt

pabesie ndaj shpalljes së pavarësisë së 17 shkurtit, qeveria e re po e zëvendëson atë me një tjetër rregullim, atë të Asociacionit. Çka është kjo Republikë ku yjet që sublimojnë barazinë mes etnive këputen një nga një dhe mbesin vetëm dy: shqiptarë e serbë? Aty ku thjerrëza e shikimit për tjetrin është etnia, aty ku mbizotërojnë narrativat nacionaliste, aty ku ndarja është rregullatori i të ardhmes, aty ku nuk ka shoqëri, aty nuk jetohej. Kosova po bëhet vend i

pabanueshëm me themelimin e Asociacionit", ka thënë ai para medieve. Ai ka shtuar se formula për konflikte të reja është drafti i ri. "Kufiri i Asociacionit ndan Kosovën përbrenda, ndërsa kufiri me Serbinë do të na thuhet që është çështje delimitimi dhe jopolitik. Kjo është qasje e përmbysur e gjërave. E ardhmja jonë do të varet nën qeverisjen e Albin Zajdnicës. Vetëm konkursi për flamurin e ri po mungon", ka thënë Molliqaj.



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN:
SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI “ORGANIZATË TERRORISTE”? (8)

Nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja Jashari e Prekazit do të duhej ta merrte!

- Nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja Jashari e Prekazit do të duhej ta merrte! / **Bernard Kouchner**

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë “Epokës së re”, në vazhdimin e pjesës së tetë, ka theksuar se përfundimi i luftës na gjeti në një gjendje tejet të rëndë. Ai ka kujtuar një takim me Rifat Jasharin në një odë të vogël që kishte mbetur e parrënuar nga kullat e Jasharëve në Prekaz, ku ishin të pranishëm edhe komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, Jetullah Geci, Bashkim Jashari, Gani Koci etj., dhe gjatë këtij takimi Bernard Kushneri i tha Rifat Jasharit: “Nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja juaj do të duhej ta merrte!”, sepse pikërisht nga sakrificat e mëdha në Prekaz bota e kuptoi realitetin e kësaj lufte!

PRISHTINË, 13 NËNTOR -
“Epoka e re”: Pas përfundimit të luftës ju keni qenë ministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. A shtroheshin pyetje rreth çështjes së civilëve të vrarë dhe të rrëmbyer gjatë luftës në Kosovë.

Bardhyl Mahmuti: Përfundimi i luftës na gjeti në një gjendje tejet të rëndë. Gjatë zbatimit të gjenocidit në Kosovë, Serbia dëboi të gjithë gazetarët e huaj që do të mund të dëshmonin për atë që ndodhte me popullin tonë dhe e shndërroi

Kosovën në “teatër me dyer të mbyllura” ku skenaristët kishin planifikuar të “luhej” tragjedia shqiptare që përmbylli tragjeditë njerëzore të shekullit XX.

Në përpjekjet për t’i fshehur gjurmët e krimit të gjenocidit, shteti serb zhvarrosi mijëra trupa të shqiptarëve të vrarë dhe i varrosi në varreza masive gjithandej Serbisë. Përveç fshehjes së kufomave të civilëve shqiptarë, gjatë tërheqjes nga Kosova, forcat serbe përdorën si mburojë njerëzore mijëra shqiptarë që deri

në atë kohë mbaheshin peng në burgjet e Kosovës.

Për të pasur një pasqyrë të përafërt me tërësinë e problemeve me të cilat duhej të ballafaqohej Qeveria e Përkohshme e Kosovës në atë kohë, nuk duhet të harrohen të mbijetuarit e gjenocidit që ishin viktimat të përdhunimit, të dhunës seksuale, të trajtimeve çnjerëzore apo poshtëruese, të dëbuarve me dhunë gjatë spastrimit etnik të Kosovës dhe shkatërrimit e tërësishme ose dëmtimet e pjesshme të 100 589 shtëpive dhe

të 88 101 objekteve përcjellëse që ishin pronë e shqiptarëve; i 358 shkollave, ku nxënësit ishin të përkatësishë etnike shqiptare; i 30 shtëpive kulturore; i 93 bibliotekave; i 123 institucioneve shëndetësore në vendbanimet ku banorët ishin kryesisht shqiptarë; i 220 objekteve të kultit fetar dhe të çdo gjëje thelbësore për shqiptarët si grup (kombëtar, etnik apo religjioz) i ndryshëm nga serbët... Megjithëse shumica e njerëzve të dëbuar që ktheheshin në Kosovë nuk kishin çati ku të futnin kokën, fati i të zhdukurve me dhunë ishte prioriteti ynë diplomatik. Ju siguroj se në të gjitha takimet me personalitete politike ndërkombëtare, me diplomatë të huaj dhe me gazetarë të medieve me peshë në hapësirën mediatike botërore, kjo çështje ka zënë vendin kryesor. *Ka rrjedhur shumë ujë nga ajo kohë dhe për shkak të rivalitetëve politike, njerëzit bëhen se kanë harruar faktin se në të gjitha takimet e kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme, z. Hashim Thaçi, apo të cilitdo ministër nuk ka mbetur pa u kërkuar ndërhyrja ndërkombëtare për lirimin e Ukshin Hotit (për të cilin mendonim se mund të*

mbahej i mbyllur nga shteti serb), Albin Kurtit, Nait Hasanit, Bajrush Xhemajlit, dhe të gjitha pengjeve të tjera që mbaheshin nga shteti terrorist serb.

“Epoka e re”: Më kujtohet se kjo çështje u shtrua edhe në takimin me ish-Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Kofi Annan, gjatë vizitës së tij në Kosovë, në tetor të vitit 1999, ku edhe unë isha pjesë e delegacionit që udhëhoqni ju. Murrëpo takimi me ish-ministrin e Punëve të Jashtme të Belgjikës, z. Louis Michel, pati një jehonë shumë të madhe mediatike.

Bardhyl Mahmuti: Ministri i Punëve të Jashtme i Belgjikës, z. Louis Michel, kishte rezervë ndaj çështjes së Kosovës. Në kërkesën tonë që BE-ja t’i përdorte të gjitha format e presionit ndaj regjimit të Sllobodan Millosheviqit për lirimin e mijëra shqiptarëve që mbaheshin si pengje në Serbi, ministri belg deklaroi se nuk mund të bënin një gjë të tillë për arsye se do të konsiderohej “cenim i sovranitetit të një shteti të pavarur”. Pas bombardimeve 72-ditëshe të caqeve serbe nga NATO, për ta detyruar Serbinë ta ndërpriste gjenocidin në Kosovë,

ishte tërësisht paradoksale të pohohej se “nuk mund të ndërhyjnë në punët e brendshme të një shteti sovran”. Në këtë kontekst shtrova hipotezën se si do të duhej të sillëshim nëse një organizatë terroriste futej e armatosur në një aeroplan dhe gjatë këtij aksioni terroristët vrasin një numër të konsiderueshëm udhëtarësh, të të gjitha moshave dhe gjinive, përdhunojnë seksualisht shumë të tjerë dhe, në fund, në bazë të marrëveshjes për t’u tërhequr nga aeroporti, gjatë tërheqjes nga aeroporti, ata marrin si mburojë njerëzore një pjesë të të mbijetuarve të këtij krimi dhe vendosen në shtëpitë e tyre private. Të pretendohet se nuk mund të ndërhyjmë në shtëpitë e këtyre kriminelëve, sepse ndërhyrja e tillë do ta cenonte pronën private, që është e shenjtë, është po aq paradoksale sa pretendimi për respektimin e sovranitetit të një shteti që pas krimeve të tmerrshme që ka bërë në Kosovë, rrëmbeu mijëra të tjerë që mbahen si pengje nën “sovranitetin e një shteti terrorist”. Nëse vërtet duhet të kemi rezultate të shpejta në këtë drejtim, atëherë Serbia duhet të kërcënohet me bombardime të reja, sepse çështja e mijëra të mbijetuarve nga gjenocidi i Serbisë në Kosovë është çështja më e rëndë e rrëmbimeve terroriste me të cilën ballafaqohet njerëzimi në këtë fundshekull.

Pikërisht arsyetimi im për kërcënimin e pushtetit në Beograd me bombardime të reja nëse nuk i lironte pengjet e rrëmbyera bëri bujën mediatike.

“Epoka e re”: A kishte diplomatë që kërkonin sqarime lidhur me sajatat serbe për, gjoja, “rrëmbimin dhe zhdukjen me forcë të civilëve nga ana e UÇK-së”?

Bardhyl Mahmuti: Fillimisht kërkesat e tilla ishin të pakta, sepse personalitetet politike, diplomatike dhe mediatike që erdhën në Kosovë menjëherë pas tërheqjes së forcave serbe, patën mundësi t’i shihnin pasojat e gjenocidit që kreu shteti serb ndaj shqiptarëve. Mirëpo, me kalimin e kohës, shtroheshin kërkesa për sqarime lidhur me pretendimet serbe.

Po përmend vetëm rastin e diplomatit amerikan Sean Burns (Shon Bërns), shef i vëzhguesve amerikanë në kuadër të Misionit

Verifikues të OSBE-së për Kosovën. Kur përfundoi mandatin e tij në Kosovë kërkoi nga unë ta shoqëroja në një takim përshëndetës me Adem Demaçin. Gjatë këtij takimi, z. Burns i kërkoi Adem Demaçit të ndërhynte tek udhëheqësit e dikurshëm të UÇK-së për lirin e të burgosurve serbë!!!

Adem Demaçi i hodhi poshtë pretendimet për të burgosur serbë që, gjoja, mbaheshin në burgjet e UÇK-së dhe i cilësoi si vazhdim i propagandës serbe kundër luftës sonë. Z. Burns u ndie në siklet dhe, i pakënaqur nga përgjigja që mori, tha: “Të jeni të sigurt z. Demaçi se unë nuk kam ardhur te Përfaqësuesi i Përgjithshëm i UÇK-së me fjalët e propagandës serbe! Gjërat që jua thashë i kam dëgjuar nga njerëz në uniformë të UÇK-së”. Në atë moment Adem Demaçi u kthye nga unë, që përktheja bisedën, dhe më tha: “Shihni mizevirat e drejt si i kanë mashtruar diplomatët amerikanë”!

Fjalën “mizevir” e kisha dëgjuar edhe më parë, por nuk ia dija kuptimin e saktë. Prandaj më shkuan disa minuta përderisa e përktheva në një kuptim më të përafërt me përmbajtjen e kësaj fjale pas sqarimeve që m’i dha Adem Demaçi.

Tani kur isha duke shkruar këto rreshta një mik imi që e njeh arabishten dhe turqishten më sqaroi prejardhjen dhe përmbajtjen e fjalës “mizevir”, e cila shënjon personat që shtrembërojnë një informacion të caktuar, falsifikojnë dokumente ose shpërndajnë fshehtas informata të pasakta!

Pastaj vazhdoi: “Z. Burns! Sot ngado që të shkosh në Kosovë, madje edhe poshtë e përpjetë pazareve, mund të gesh uniforma të UÇK-së! Qofshin me uniforma, me veshje civile apo cullak, ata që ju paskan thënë një gjë të tillë, ju kanë gënjer...”! U kthye nga unë duke lëkundur kokën në formë qortuese dhe përsëriti dy herë shprehjen: “Mizevirat e drejt!”

“Epoka e re”: Ju thatë se pas përfundimit të luftës personalitete të personalitete të ndryshme politike, diplomatike dhe mediatike ndërkombëtare patën mundësi t’i shihnin përmasat e krimeve në Kosovë. Në kujtesën tonë ka mbetur shoqërimi që i bëti



Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Bernard Kushner (Kushner), në Prekaz, dhe sidomos fjalët që tha në Kullë të Jasharëve. Në librin autorial “Luftëtarët e paqes: nga Kosova në Irak” Bernard Kushner jep disa të dhëna rreth vizitës së tij në Drenicë që ia organizuat ju. Çfarë mund të thonit për këtë ngjarje?

Bardhyl Mahmuti: Edhe në atë vizitë, për organizimin e së cilës një kontribut shumë të rëndësishëm ka dhënë Ramiz Lladrovci, kemi qenë së bashku. Më duhet të sqaroj për lexuesin diçka që i parapriu asaj vizite. Një ditë më parë një femër e përkatësisë etnike serbe ishte ankuar tek autoritetet e Misionit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën (UNMIK) se dikush nga shqiptarët i kishte rënë një grusht në fytyrë dhe ajo kishte syrin e mavijosur. Zoti Kushner kërkoi nga përfaqësuesit politikë shqiptarë ta dënonin këtë akt dhune dhe, për këtë qëllim, mbajti disa konferenca shtypi të përbashkëta me liderë partish. Kërkoi prej meje të bënim të njëjtën gjë.

Duke mos përjashtuar asnjë hipotezë lidhur me atë se kush mund të qëndronte prapa një akti të tillë, rrjedhimisht duke mos përjashtuar si mundësi as dhunën familjare, unë refuzova të dilja në konferencë me gazetarë dhe të jepja qëndrime rreth një ngjarjeje

që nuk e dija si kishte ndodhur. Pas insistimeve të shumta të Kushnerit, unë i vura kusht që përpara se të dilnim në konferencë shtypi për një rast të tillë, ta vizitonim Drenicën. Ai pranoi kërkesën time dhe të nesërmen në mëngjes u nisëm për në Drenicë. Ishim në të njëjtën veturë dhe gjatë rrugëtimit pati mundësi t’i shihte shkatërrimet e mëdha që dëshmonin për barbarinë serbe dhe ta shihte vërtetësinë e asaj që i kisha thënë një ditë më parë. Nga kthesa te kryqi i Komoranit e deri në Prekaz më falënderoi disa herë që i propozova të shihje një pjesë të realitetit, që e kishte parë vetëm në sekuenca të shkurtra televizive. Me sa më kujtohet, në një odë të vogël që kishte mbetur e parrënuar nga Kullat e Jasharëve në Prekaz, na prit me zemër të madhe Rifat Jashari. Aty ishte edhe komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sami Lushtaku, Jetullah Geci, Bashkim Jashari, Gani Koci etj. Pikërisht gjatë këtij takimi z. Bernard Kushner i tha Rifat Jasharit: “nëse do të kishte çmim Nobel për liri, familja juaj do të duhej ta merrte!”, sepse pikërisht nga sakrificat e mëdha në Prekaz bota e kuptoi realitetin e kësaj lufte. Pas vizitës së gërmadhave të Prekazit, shkua në Poklek. Në hyrje të oborrit të familjes Muçolli, në lartësi rreth 160 cm në të djathtë të derës, shiheshin njolla gjaku. Aty ishin vrarë dy burra në moshë. Në brendi të shtëpisë gërmadhë, ku trarët dukeshin si zorrë nëpër këmbë, kundërmonte erë gjaku dhe gome të djegur. Na treguan se në një rën nga dhomat kishin shpëtuar pa u djegur tërësisht katër kufoma vajzash të reja, ndërkaq mbetjet e 47 “familjarëve të terroristëve” ishin futur në një gropë tjetër. Në një skaj të dhomës, ku kishin qenë të ngjuar edhe fëmijët deri në çastet e fundit të jetës së tyre, Bernard Kushner mori një grusht sërçash të ngjitura mes tyre nga temperatura e lartë.

I tregova se, përveç anëtarëve të familjes Muçolli, në këtë shtëpi ishte ekzekutuar shkrimtari Ymer Elshani së bashku me nënën e vet Nailen (75 vjeçe), bashkëshorten Nafijen (45 vjeçe) dhe katër djemtë: Nderimi (10 vjeçe), Kujtimi

(15 vjeçe) Mirani (20 vjeçe) dhe Ardiani (25 vjeçe).

Kur dolëm nga gërmadha e shtëpisë së familjes Muçolli në oborr, kishin ardhur dy të mbijetuar të krimit të gjenocidit në Poklek (një grua e re e asaj shtëpie dhe një vajzë e vogël që kishin arritur të largoheshin, megjithëse të plagosura) dhe një ushtar i UÇK-së, pjesëtar i kësaj familjeje. Bernard Kushner, i mallëngjyer tej mase, e mori vajzën e vogël në krah dhe filloi t’ia ledhatonte kokën. Në atë çast ndërhyri ushtari i UÇK-së dhe kërkoi nga unë t’i përktheja fjalët që dëshironte t’i thoshte Kushnerit. Nuk më kujtohet emri i këtij ushtari, por ajo që i tha më ka ngelur e ngulitur thellë në kujtesën time dhe jam i sigurt se nuk do ta harroj derisa të vdes: “Zoti Kushner! Vajza që mbani në krah është gjashtë muaj më e madhe se vajza ime e madhe që u vra nga forcat serbe në këtë shtëpi! Në këtë shtëpi janë vrarë 53 shqiptarë: 2 pleq, 23 fëmijë dhe 28 gra! Unë humba gruan, tre fëmijë dhe ... Ju lidhën fjalët nyje! Dëgjoni zoti Kushner! Unë kam kapur pushkën të luftoj për lirinë e vendit tim dhe t’u dal përballë forcave serbe, me armatim që nuk mund të krahasohet me armët që kishim ne. Çdo ditë kemi marrë lajme të hidhura dhe tepër tragjike për vrasje masive të civilëve shqiptarë, por asnjëherë nuk më ka shkuar ndër mend të hakmerrem ndaj civilëve serbë! Dhe shihni çfarë na kanë bërë...” U përshëndet me ne megjithëse mjekra i dridhej nga dhembja e madhe dhe shkoj.

Mbretëroi heshtje varri. Hipëm në vetura dhe u kthyem në Prishtinë! Gjatë gjithë kohës nuk këmbënim as dy-tri fjalë!

Bernard Kushneri nuk e përmendi më kurrë kërkesën e tij të dilnim në konferencë për shtyp për ta dënuar dhunën që një serbe pretendonte se ia kishte bërë një shqiptar! Disa vjet më vonë ai e përshkroi udhëtimin në Drenicë dhe nuk harroi ta përmendte as grushtin me sërça të ngjitura nga temperatura e lartë gjatë djegies së kufomave për t’i fshehur gjurmët e krimit të gjenocidit.

(Muhamet Mavraj / Vjion)



Kongresi XIV Mbarëkombëtar i Pulmologjisë mbledh pulmologët nga të gjitha trojet shqiptare

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka marrë pjesë në Kongresin XIV Mbarëkombëtar të Pulmologjisë, i organizuar nga Asociacioni i Pulmologëve të Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e Pneumologëve të Shqipërisë. Në mesin e kolegëve dhe profesionistëve shëndetësorë, pulmolog Vitia në fjalën përshëndetëse si një student i Tiranës shprehi kënaqësinë që

ky kongres bashkoi profesionistët nga të gjitha trojet shqiptare. "Ky kongres që bashkon pulmologët nga të gjitha trojet shqiptare, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë në këtë fushë të ndërlikuar shkencore, është pjesë e rëndësishme e një koordinimi të domosdoshëm profesional dhe institucional", ka thënë Vitia. Vitia theksoi se ky kongres do të

sjellë mundësi për të ndërtuar lidhje të reja, për ta përmirësuar komunikimin institucional dhe bashkëpunimin ndërmjet shkencëtarëve dhe mjekëve dhe për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm njohurish dhe burimesh për të ardhmen. Ngjarje të tilla na kujtojnë rëndësinë se bashkëpunimi në mes të pulmologëve shqiptarë duhet të thellohet dhe të jetë i qëndrueshëm.



UNDP-ja dhe komuna e Prizrenit shënuan përfundimin e fushatës "E Du Prizrenin"

PRIZREN, 13 NËNTOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, së bashku me komunën e Prizrenit, kanë shënuar përfundimin e fushatës sensibilizuese "E Du Pz" në shtëpinë e Shani Efendisë, një rezidencë tradicionale në zemër të Prizrenit.

Ceremonia ishte përmbledhja e një fushate ambicioze dhe me ndikim që synonte zbulimin e thesareve historike të qytetit përmes një iniciative të kodit QR. Kjo përpjekje inovative integroi tabela informative digjitale në 15 lokacione historike, duke u mundësuar vizitorëve qasje të plotë në www.eduprizrenin.com. Aty u bënë bashkë palët e interesuara vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë kryetarin Shaqir Totaj, Yuliya Shcherbinina, zëvendësperfaqësuesen e Përherëshme e UNDP-së, të ftuar, pjesëmarrës të fushatës dhe përfaqësues komunalë dhe të UNDP-së.

Fushata, me prani të gjerë në



mediet sociale, tërhoqi rreth 70 pjesëmarrës aktivë me më shumë se 150 foto të dërguara për

konkurrim në Facebook dhe Instagram, veçanërisht brenda komunitetit lokal. Publiku mori

pjesë aktive duke ndarë, ndjekur dhe kontribuar përmbajtjen, duke nxitur një ndjenjë të

pronësisë dhe entuziazmit kolektiv. Fotografët vendas kontribuan me materiale që u bënë gurthemeli i përmbajtjes vizuale të fushatës, duke portretizuar një perspektivë të freskët dhe të gjallë të një qyteti të mbushur me histori të patreguara.

Nga të gjitha aplikimet që janë dorëzuar me hashtag #edupz janë përzgjedhur 12 fotot më të mira. Këto janë vlerësuar nga publiku të cilit iu kërkua të votonte për pesë ditë dhe t'i zgjidhte fotot fituese. Me votë popullore fituesit janë: 1. Artan Misini - Kalaja e Prizrenit; 2. Furkan Drvenica - Kroi i Shatërvanit; dhe 3. Senad Kahraman - Peisazhi i Prizrenit. Logoja e fushatës, me hashtag-un "E Du Prizrenin", u përfaqëua me shpejtësi nga ekipi lokal i basketbollit dhe ndërmarrjet e vogla private dhe gjeti rrugën deri te sektorë dhe aktivitete të ndryshme, duke shfaqur potencialin për ta zgjeruar ndikimin në fusha të ndryshme.

Publikohet programi për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit publikuan Programin për Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

KOMF-i ka mbështetur Zyrën për Qeverisje të Mirë në hartimin e këtij programi, i cili përmban katër module dhe i cili do të përdoret nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës për ngritje të kapaciteteve. Krahas kësaj, gjatë vitit të kaluar KOMF-i dhe Zyra për Qeverisje të Mirë e Kryeministrit kanë mbajtur 13 punëtori dyditore me të gjitha komunat, për informim të profesionistëve mbi përmbajtjen

e këtij ligji.

Modulet kryesore që e përbëjnë këtë program janë: qëllimi, fushëveprimi dhe parimet e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, mekanizmat institucionalë, roli dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijës, sistemi dhe masat për mbrojtjen e fëmijës dhe mbrojtja e fëmijës.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve për mbrojtjen e fëmijës në nivel komunal dhe qendror për ta zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme. Modulet dhe përmbajtja janë një



aset edukativ i munguar në fushën e mbrojtjes së fëmijës, veçanërisht në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, që është i pari i këtij lloji

në Kosovë, dhe i cili sjell shumë risi dhe aspekte që kërkojnë vëmendjen e shtuar dhe koordinimin institucional për

zbatimin e tij në praktikë.

Gjatë ceremonisë së publikimit të këtij programi morën pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, Qeveria e Kosovës, drejtoritë komunale, qendrat për punë sociale, agjencitë ndërkombëtare, organizatat joqeveritare etj.

Zhvillimi i programit të LMF dhe kjo ngjarje u mundësuan në kuadër të projektit "Fuqizimi i akterëve të shërbimeve sociale për të ofruar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e cënueshme në Kosovë", i cili mbështetet nga UNICEF-i në Kosovë në partneritet me USAID-in.

244 fermerë nga Skenderaj mbështeten nga programi i bujqësisë

SKENDERAJ, 13 NËNTOR - Komuna Skenderaj ka mbështetur 244 fermerë në kuadër të programit të bujqësisë falë marrëveshjes së

bashkëpunimit me Islamic Relief Kosova. Kryetari i kësaj komune, Fadil Nura, ka njoftuar se 25 fermerë kanë përfituar serra me nga 5 ari,

ndërsa 78 të tjerë me nga 1 ari, 71 fermerë kanë përfituar motokultivatorë dhe 70 të tjerë pula. "Një tjetër rast si ky që tregon përkushtimin tonë me

angazhim të vazhdueshëm për ta zhvilluar bujqësinë dhe mbështetur fermerët e vyer!", ka shkruar Nura në "Facebook".



Mbi 1 350 qytetarë në veri kanë reregjistruar veturat e tyre me targa RKS

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Interesim i madh është vërejtur gjatë këtyre ditëve nga qytetarët në veri të Mitrovicës për reregjistrimin e automjeteve me targa ilegale serbe në ato RKS-Republika e Kosovës. Që nga 1 nëntori e deri më sot mbi 1 350 qytetarë kanë aplikuar për reregjistrim të veturave në veri. Kështu ka bërë me dije për "Telegraf"-in ushtruesi i detyrës së drejtorit të policisë për veri, Veton Elshani. Ndërkaq nga Ministria e Punëve të Brendshme kanë deklaruar për "Telegraf"-in se mirëpresin vullnetin e qytetarëve që t'i përgjigjen pozitivisht vendimit të qeverisë. "Mirëpresim vullnetin e shtuar të qytetarëve tanë të komunitetit serb të cilët po i përgjigjen pozitivisht vendimit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Nga fillimi i vendimit deri më sot 1 354 qytetarë kanë



konvertuar targat e tyre nga ilegale në të Republikës së Kosovës. Komuna e Mitrovicës në veri dhe Leposaviqi ka pasur numrin më të madh të konvertimeve deri më sot", ka deklaruar zëdhënësja e MPB-së, Nora Fetoshi. Ajo u ka bërë thirrje qytetarëve të

vazhdojnë ta bëjnë reregjistrimin e veturave. "Ftojme të gjithë qytetarët tanë, të cilët posedojnë mjete të pajisura me targa ilegale që të vazhdojnë t'i regjistrojnë mjetet e tyre me targa RKS dhe të përfitojnë nga lehtësirat financiare deri më 1 dhjetor 2023", tha Fetoshi.

Qeveria e Kosovës më 30 tetor vendosi për shtyrjen e afatit për reregjistrimin e automjeteve me targa ilegale serbe në ato RKS - Republika e Kosovës. Shtyrjes së afatit i parapriu një kërkesë nga Drejtoria e Policisë së Kosovës për rajonin e veriut drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Kjo kërkesë u bazua në kërkesat e qytetarëve që kërkuan që ky afat të vazhdohej. Sipas vendimit të qeverisë, afati për reregjistrimin e makinave me targa serbe sikurse "PR", "KM", "PZ" e të ngjashme do të jetë deri më 1 dhjetor. Çështja e targave në të kaluarën ka shkaktuar një sërë krizash në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. Fillimisht, më 31 korrik të vitit 2022 u ngritën barrkada për shkak të çështjes së targave dhe në nëntor të po atij

viti, serbët u larguan nga institucionet e Kosovës në veri, pasi u suspendua drejtori i policisë për rajonin e veriut, Nenad Gjuriq. Gjuriqi kishte refuzuar ta zbatonte vendimin e Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS. Plani i Qeverisë së Kosovës i tetorit të vitit të kaluar parashihte që nga 21 prilli i vitit 2023 të lejohej vetëm qarkullimi i makinave me targa RKS. Më 23 nëntor 2022, në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për targat që lëshohen nga autoritetet serbe për qytetet në Kosovë. Sipas marrëveshjes, Serbia pranoi që të mos lëshonte më targa të reja dhe Kosova hoqi dorë nga ndëshkimet që parashihte plani për reregjistrimin e makinave.

Mbahet Kuvendi Zgjedhor i Degës së PDK-së në Francë, kryetar zgjedhet Sami Islami



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Në një atmosferë të mrekullueshme, në Paris, me pjesëmarrjen e kryetarit të Komisionit për Organizimin e PDK-së në Mërgatë, deputetit Elmi Reçica, nënkrytares Vlora Çitaku dhe deputetëve Blerta Deliu-Kodra e Rashit Qalaj, u mbajtën

punimet e Kuvendit Zgjedhor të Degës së PDK-së për Francë, me ç'rast u zgjodhën strukturat drejtuese të degës: kryetari, Këshilli Drejtues prej 41 anëtarëve si dhe Kryesia e Degës bashkë me nënkryetarët dhe sekretarët. Kryetar u zgjodh aktivisti dhe

afaristi i shquar Sami Islami. Deputeti Reçica ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës po organizohet, strukturohet e fuqizohet në mërgatë pasi, sipas tij, mbështetja për të po rritet. "Organizimi ynë në mërgatë, përveç që i bën bashkë qytetarët dhe krijon kohezion shoqëror,

është në shërbim të avancimit të rolit të tyre brenda dhe jashtë kufijve të Kosovës", ka thënë Reçica, duke i përgëzuar të gjithë aktivistët e partisë në shtetin e Francës të cilët me punën e tyre mundësuan një organizimin të tillë fantastik. "Nga sot nuk përfundon, por

fillon një mision shumë patriotik e fisnik: misioni për ta bërë Partinë Demokratike të Kosovës subjektin më të madh politik të shqiptarëve në Francë, dhe ky mision është edhe për ta bërë PDK-në subjektin e parë në mërgatë dhe në Kosovë", ka thënë ai.

Kroacia trajnon Policinë Ushtarake të FSK-së

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Në kuadër të planit të bashkëpunimit bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes së Kroacisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës në Kazermën "Croatia" në Zagreb një skuadër e Policisë Ushtarake e FSK-së (PU) ka ndjekur trajnimin "MP Electroschock Stun Gun

Training and MP Drug Test Training". Trajnim është udhëhequr nga instruktorët e Policisë Ushtarake Kroate dhe ka plotësuar të gjitha objektivat dhe qëllimin në kuadër të përgatitjeve profesionale për pjesëtarët e PU të FSK-së. Në ceremoninë e certifikimit i pranishëm nga FSK-ja ishte atasheu i Mbrojtjes në

Republikën e Kroacisë, nënkolonel Shpend Zogaj, që në emër të komandantit të FSK-së ka falënderuar ushtrinë kroate për ndihmën që po jep për ngritjen profesionale dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që ka Forca e Sigurisë së Kosovës me Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë në të gjitha fushat e zhvillimit.



Ndërmarrja "Trepça" shpall konkurs për kryeshef ekzekutiv

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ndërmarrja "Trepça" ka shpallur konkurs për kryeshef ekzekutiv, pas shkarkimit të Enis Abdurrahmanit, i cili ishte për rreth dy vjet pati ushtrues

detyre.

Në konkursin e bërë në uebfaqen e tyre zyrtare, thuhet se kryeshefi do të vlerësohet vazhdimisht nga Bordi i Drejtorëve dhe se kontrata do të jetë trevjeçare

me mundësi vazhdimi.

Afati për aplikim do të jetë i hapur deri më 28 nëntor. Minatorët kishin mbajtur grevë për 10 ditë, ku në kërkesat e paraqitura ishte edhe shkarkimi i

menaxhmentit. Greva ishte ndërprerë pas marrëveshjes së arritur ndërmjet ndërmarrjes dhe minatorëve, kur edhe ishin pajtuar për plotësimin e kërkesave të tyre.



Rriten çmimet, rëndohet për 3.3 % më shumë shporta e qytetarit

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 3,3 % në muajin tetor 2023 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Bazuar në të dhënat e ASK-së, kjo rritje kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: perimet (15,9 %), pemët (12,1 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (11,1 %), gjërat dhe pajisjet e tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (8,4 %), prodhimet ushqimore (7,5 %), pijet joalkoolike (6,9 %), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (6,9 %), pijet alkoolike, duhani (5,6 %), rekreacioni dhe kultura (5,3 %), mobilie, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë (5,1 %), blerja e automjeteve (4,9 %), buka dhe drithërat (4,7 %), restorantet dhe hotelet (4,1 %), veshje dhe këpucë (3,5 %), mallrat dhe shërbimet e ndryshme (3,2 %), energjia elektrike, gaz dhe lëndët djegëse të tjera (2,6 %) dhe mish (2,1 %)

me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,8-përqindësh në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-11,3 %), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj (-9,5 %) dhe qumështi, djathi dhe vezët (-1,8 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,5-përqindësh në IHÇK.

Pavarësisht prej mos në muajin tetor 2023 të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit krahasuar me muajin shtator 2023 vërehen disa ndryshime të çmimeve të artikujve dhe shërbimeve të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it.

Rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-1 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,1 përqindësh në IHÇK. Ndërsa ngritja e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: veshjet dhe këpucë (1,7 %) dhe mallrat dhe shërbimet e ndryshme (1,2 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,1-përqindësh në IHÇK.



KEDS-i po realizon 16 projekte në Klinë me vlerë mbi një milion euro



KLINË, 13 NËNTOR - Në kuadër të qindra projekteve që aktualisht po realizohen në Kosovë, së fundi KEDS ka filluar zbatimin e 16 projekteve në disa fshatra të komunës së Klinës. Konkretisht, në projektet që po realizohen në fshatrat Jashanicë, Siqevë, Dresnik, Gllarevë, Zabergj, Volljakë, Sverkë dhe Rudica, rrjeti do të jetë komplet i ri së bashku me stabilimentet përkatëse. Aktualisht po punohet në punët përgatitore, bashkë me vendosjen e stabilimenteve të nevojshme elektroenergjetike.

Sipas planit investiv të KEDS-it, parashihet vendosja e 868 shtyllave elektrike të betonit dhe 12 transformatorëve. Me realizimin e këtyre projekteve do të përfitojnë më shumë se tre mijë banorë të asaj ane. Këto projekte, të cilat kapin një shumë mbi një milion euro, parashihet të përfundojnë përgjatë periudhës 2024-2025. Me përfundimin e tyre do të eliminohen edhe linjat e vjetra elektrike të cilat kanë qenë të vendosura nëpër terrene të papërshtatshme për mirëmbajtjen e tyre nga ana e KEDS-it.


Inspektoratit të Punës i shtohen edhe 19 inspektorë

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Inspektoratit të Punës i shtohen edhe 19 inspektorë të rinj të punës. Inspektorati i

Punës ka njoftuar se që nga viti i kaluar 2022 e deri më tani Inspektorati i Punës ka rekrutuar 38 inspektorë të

rinj të punës duke e ngritur numrin total të inspektorëve të punës në 60. Numri i inspektorëve të punës do të

vazhdojë të rritet me qëllimin e mbikëqyrjes sa më të mirë të të drejtave të punëtorëve.



Të pasur dhe besimtarë? Ja çfarë thonë 5 fetë kryesore për paranë

Duke qenë se paraja ka qenë në qendër të shoqërisë njerëzore për 5000 vjet, nuk është çudi që të gjitha fetë kryesore kanë shumë për të thënë për të. Asnjë fe e madhe sot nuk inkurajon aktivisht pasurinë dhe lakminë. Megjithatë, një vështrim i shpejtë përreth jush do të zbulojë shumë besimtarë të pasur. A janë hipokritë? Varet. Secila fe ka një qasje të ndërlëkuar dhe me nuanca ndaj parasë, që mund të mos jetë aq e frikshme.

“Sepse dashuria për paranë, është rrënja e gjithë të ligave”

Timoteu 6:10

Qoftë nëse bëhet fjalë për shifrat në ekranin e bankomatit apo për një çantë floriri përrallash, dëshira për pasuri është po aq e vjetër sa vetë shoqëria njerëzore. Sipas dëshmiave më të mira arkeologjike, “paratë” datojnë të paktën 5000 vjet më parë. Dhe, duke pasur parasysh se librat më të vjetër të shenjtë që kemi – një ballafaqim midis Rigvedës së hinduizmit dhe Tanakhut hebre – janë shkruar rreth vitit 1300 pes, ka kuptim që fetë kryesore botërore të kishin shumë për të thënë për paratë. Por, siç mund ta imagjinoni, mesazhet shpesh nuk janë të qarta. Ndërsa Timoteu 6:10 është një pasazh i famshëm biblik, është e qartë për këdo që i ka hedhur një vështrim kalimthi Kishës Katolike ose të krishterëve në mbarë botën, se ka shumë dashuri për paranë. Po kështu, ndërsa Kurani, Dhammapada, Bhagavad Gita dhe Tanakh përmbajnë të gjitha ndalime të pasurisë së tepërt, bota është e mbushur me myslimanë, budistë, hindu dhe hebrej shumë të pasur. Pra, a janë këta njerëz të gjithë hipokritë? Përpara se të hedhim gurin e parë, ndoshta duhet të shqyrtojmë se çfarë thonë në të vërtetë ato fe.

Shtegu i Artës

Një gjë duhet të bëhet e qartë që në fillim: Asnjë tekst i shenjtë sot nuk është në favor të lakmisë së shfrenuar, pasurisë së pacipë ose metodave të liga të fitimit. Por kjo nuk do të thotë se ata mësojnë që paratë janë gjithmonë të këqija. Ndoshta miratuesi më aktiv i pasurisë është hinduizmi. Në hinduizëm, ka katër qëllime në jetë (të njohura si Purusharthas), por ato ndoshta kuptohen më mirë si tre rrugë drejt një destinacioni të vetëm. Fundi final i jetës, qëllimi i qëllimeve (parama-purusārtha), është Moksha, që do të thotë çlirim nga cikli i rilindjes. Rruga për në Moksha, pra, kërkon tre gjëra: Kama (kënaqësi dhe gëzim), Dharma (drejtësi, vepra të mira dhe detyrë) dhe Artha (pasuri dhe begati materiale). Ajo që Hinduizmi e bën të qartë është se pa pasuri apo para, është shumë më e vështirë të shijosh jetën dhe të jesh plotësisht Dharmik. Ata që janë krejtësisht të varfër kanë pak burime për të


kënaqur Kamën. Është ndoshta e pavërtetë ajo shprehja: “Paraja nuk mund të blejë lumturinë”. Sigurisht që ndihmon. Për hinduizmin, vetëm kur kemi para mund ta shijojmë plotësisht jetën dhe të ndihmojmë plotësisht njerëzit e tjerë.

Zotërim pa dëshirë

Në budizëm, paraja në vetvete nuk ka asgjë thelbësisht të keqe, por ka diçka që nuk shkon me dëshirën për të. Një nga këshillat qendrore të Budizmit është të shkëputemi nga bota e gjërave materiale sa më shumë që të mundemi. Ne duhet të synojmë të përqendrohemi në kapërcimin e realitetit tonë të zakonshëm (i cili ndoshta është iluziv, gjithsesi) dhe në ndjekjen e iluminizimit. Siç na këshillon Dhammapada, “Nuk ka zjarr si epshi, nuk ka zinxhir si urrejtja, nuk ka kurth si mashtrimi dhe asnjë përrua si dëshira shfrenuar”. Lidhja me familjen, miqtë, pasurinë dhe, po, paratë është një mënyrë e sigurt për të mos e lënë kurrë Samsaran (ciklin e rilindjes). Por ka një tjetër këshillë të Budizmit që është mjaft delikate. Ndërkohë që nuk duhet të lidheni me paratë, mund të dalloni gjithashtu potencialin e madh për të mirën e parasë. Në të njëjtën mënyrë që hindutë besojnë se Artha është e nevojshme për Dharman, disa budistë pohojnë se bërja e pasurisë është e mirë për sa kohë që rishpërndahet dhe përdoret virtutshëm.

Ai që ju jep pasurinë tuaj

Nuk ka asgjë të gabuar me pasurinë si në tekstet e hebrejve ashtu edhe në Tanakh. Paratë dhe pasuritë, si të gjitha gjërat, duhet të jepen dhe të merren nga Zoti. Siç thotë Ligji i Përtërirë 8:18, “Por kujtoni Zotin, Perëndinë tuaj, sepse është ai që ju jep aftësinë për të prodhuar pasuri.” Ndryshe nga krishtërimi dhe islami, hebrejtë nuk u ndaluan kurrë së dhëni para, prandaj, historikisht, ata morën rolin e bankierëve dhe huadhënësve. Por askund në judaizëm nuk inkurajohet lakmia apo egoizmi. Ndërsa Levitiku 19 lejon pronësinë e tokës dhe prodhimin e verës, ai u thotë gjithashtu judenjve që të lënë një pjesë të pasurisë “për të varfërit dhe të huajt”. Ndërsa Eksodi 22 lejon dhënien e parave, ai gjithashtu thotë: “Nëse i jep hua ndonjërit nga njerëzit e mi që është i varfër... nuk do të kërkoj interes



prej tij.” Bamirësia, mirësia dhe përdorimi i pasurisë për të mirë shfaqen vazhdimisht, nga dijetari Maimonides e deri te rabinët e sotëm. Në qendër të shumë hebrejve që praktikojnë është ideja e tzedakah. Tzedakah nuk është thjesht bamirësi (është gjithashtu), por edhe ndërgjegje shoqërore dhe drejtësi – një vetëdije dhe pasion për ta bërë botën më të mirë.

Më e lehtë për një deve

Për shkak se krishtërimi është një nga fetë më të njohura në botë, është shkruar shumë për hipokrizinë në mënyrën se si i qaset parasë. Jezusi ishte djali i varfër i një marangozi të varfër në një provincë të varfër të Perandorisë Romake. Tek Mateu, ai tha qartësisht: “Nuk mund t’i shërbesh Perëndisë dhe parasë” dhe: “Është më e lehtë për një deve të kalojë nëpër vrimën e gjilpërës, sesa për një të pasur të hyjë në mbretërinë e Perëndisë”. Një nga Etërit më të mëdhenj të Kishës – Agustini – madje e krahasoi dashurinë për para me idhujtarinë (e cila, në atë kohë, dënohej me vdekje). E megjithatë, Kisha Katolike sot ka 3 miliardë dollarë në aset

financiare dhe pasuri të pamatshme nëse merrni parasysh vlerën e shitjes së pronës së saj të kishës, artit, relikteve dhe objekteve të tjera. Bill Gates, Beyonce dhe Chris Pratt janë të gjithë të krishterë praktikues. Të gjithë kanë një ose dy qindarka të kursyera. Si e kuptojnë këtë të krishterë? Ashtu si me Judaizmin, shumë teologji kristiane përqendrohen në idenë e “administrimit”. Zoti jep pasuri dhe (në disa lloje protestantizmi) madje shpërblim për ata që punojnë shumë. Na takon ne t’i përdorim ato para mirë dhe për vepra të mira. Timoteu (i famshmi i shprehjes “rrënja e çdo të keqeje”) madje nënkupton se të jesh i pasur është mirë, për sa kohë që nuk shoqërohet me arrogancë dhe një largim nga Perëndia. Pasuria dhe paratë nuk janë të këqija, por duhet të përdoren mirë. Ato madje mund t’ju lejojnë të bëni mirë.

Mos e konsumoni pasurinë e njëri-tjetrit padrejtësisht

Duke pasur parasysh se është e fundit nga tre fetë abrahamike, nuk mund të jetë çudi që Islami është i ngjashëm me Judaizmin

dhe Krishtërimin në mënyrën se si i sheh paratë. Ashtu si ata, pasuria nuk është e keqe në vetvete (Harām), por mund të merret keq (mal-Harām), të shpenzohet keq (tabdhir), ose të shpërdorohet për gjëra të kota (israf). Kur’ani thotë: “Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote” dhe këshillon: “Mos lejoni pasuritë dhe fëmijët tuaj, t’ju largojnë nga përmendja e Allahut”. Një nga “Pesë Shtyllat e Islamit” (të cilat janë besimet dhe sjelljet themelore të muslimanëve) njihet si Zekati. Kjo është lëmosha e detyrueshme, ku të gjithë muslimanët duhet të japin një pjesë të pasurisë së tyre (tradicionalisht 2.5% të pasurisë së tyre) për bamirësi ose për të varfërit. Të pamend janë ata që nuk e japin zekatin e tyre, sepse siç thotë hadithi (Buhariu): “Kush pasurohet nga Allahu dhe nuk e paguan zekatin e pasurisë së tij, atëherë në Ditën e Kiametit pasuria e tij do të bëhet si një gjarpër helmues me dy pika të zeza mbi sy. Gjarpri do t’i rrethojë qafën, do t’i kafshojë faqet dhe do t’i thotë: “Unë jam pasuria jote, unë jam thesari yt”. Që është makthi i maktheve. / big think – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Policia e Kosovës: Asnjë incident nuk ndodhi në ndeshjen Kosovë - Izrael

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka mposhtur të dielën në mbrëmje Izraelin me rezultat 1-0. Për ndeshjen e zhvilluar, konkretisht situatën e sigurisë, ka lëshuar komunikatë Policia e Kosovës. Sipas

njoftimit të policisë, kjo ndeshje ka kaluar pa asnjë incident. "Policia e Kosovës, në bashkëpunim dhe koordinim me FFK-në dhe akterët relevantë, ashtu siç e ka bërë të ditur me kohë, ka bërë planifikimet e saja operacionale

për menaxhimin dhe mbarëvajtjen sa më të mirë të kësaj ndeshje sportive, duke u kujdesur për ofrimin e sigurisë që nga ardhja e kombëtares së Izraelit në Republikën e Kosovës e deri në kthimin e saj për në Izrael. Policia e Kosovës

falënderon qytetarët, mediet dhe të gjitha institucionet për bashkëpunimin korrekt me Policinë e Kosovës, të cilët janë pjesë e meritës që ky event sportiv të kalojë i qetë dhe pa incidente", thuhet në komunikatën e PK-së.



Ballkani i pagabueshëm ndaj Dukagjinit

Ballkani po ecën sigurt drejtë titullit të kampionit në elitën e futbollit të Kosovës. Skuadra që drejtohet nga Ilir Daja, tash ka plotë shtatë pikë me shumë se skuadra e dytë në renditjen tabelore, Drita. Madje kampionët në fuqi e kanë edhe një ndeshje me pak të zhvilluar

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Suharekë, 13 nëntor - Skuadra e Ballkanit ka shënuar fitore me rezultat 3-1 në ndeshje ndaj Dukagjinit të Klinës. Kjo ndeshja u zhvillua sot në stadiumin e qytetit në Suharekë dhe i ka takuar javës së 14-të në Superligën e Kosovës në futboll.

"Ne vazhdojmë me fitore dhe kjo është shumë e rëndësishme për neve, pasi po luajmë edhe në Evropë. Grupi nuk është më me 12 apo 13 lojtarë, por 16 e më tepër që janë të gatshëm për të treguar veten si në kampionat ashtu edhe në Evropë. Besoj se vazhdimësia me fitore na bën me të qetë për vazhdimin e kampionatit. Është një fitore që na jep qetësinë për të

vazhduar tutje. Sigurisht fitoret janë pjesë shumë e mirë për grupin, i cili po shfaq mentalitet fituesi. E gjithë kjo ecuri pozitive ka një vlerë shumë të madhe, duke nxjerr në pah karakterin e jashtëzakonshëm me grupin", ka thënë Ilir Daja, trajner i Ballkanit. Vendasit kaluan pas pesëmbëdhjetë minutave lojë me anë të Nazmi Gripshit, i cili u tregua i sakët nga penalltia. Mysafirët nga Klina arritën të barazojnë rezultat në fund të pjesës së parë me anë të Viktor Hugos. Katër minuta pasi filloi pjesa e dytë, kampionët e Ballkanit e rikthyen epërsinë në 2-1 me golin e shënuar nga Kryeziu. Ballkani realizoi edhe golin e tretë dhe të fundit në ndeshje në minutën e 89-të, autor i golit ishte Tolaj. "Është zhgënjyese



pasi treguam lojë të mirë dhe krijuam raste, por kështu e ka futbollit. Ne kishim mungesa të shumta në këtë ndeshje, por e rëndësishme është se ekipi e dha maksimumin dhe këto ishin

mundësitë tona. Me pak fat, mund ta kishim marrë edhe një barazim. Por, nga kjo humbje duhet të marrim një mësim për ndeshjet e ardhshme dhe secili lojtar të jap më të mirën nga vetja në secilën

ndeshje dhe të marrë përgjegjësitë. Defektet që i patëm në këtë ndeshje, besoj se do t'i përmirësojmë dhe nuk do të na përsëriten për ndeshjet tjera. Goli i treti na i humbi shpresat për barazim, pasi erdhi si rezultat i gabimit të mbrojtjes", ka deklaruar pas ndeshjes Armend Dallku, trajner i Dukagjinit. Pas tri pikëve të reja skuadra e Ballkanit vazhdon kryesimin në elitë me 32 pikë, derisa Dukagjini mbetet në vendin e gjashtë me 17 pikë. Tri ndeshje tjera të kësaj xhiro në elitë janë zhvilluar të shtunën. Prishtina barazoi me Lirinë (2-2). Kryeqytetasit avancuan me dy gola të shënuara nga Blesas (3) dhe Kryeziu (9), por në pjesën e dytë skuadra prizrenase shfaqti lojë dukshëm më të mirë dhe arriti të shënojë dy gola përmes Stafës (75) dhe Megamenos (83). Drita ka marrë pikët e plota në duel me Fushë Kosovën (1-0), falë golit që Besnik Krasniqi (84). Me rezultat 1-0 regjistroi fitore edhe Llapi ndaj Feronikelit '74, derisa golashënues i ndeshjes ishte Hamdi Namani (29).

Ujkani: Pritja e 'Dardanëve' më emocionoi dhe nderoi



PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ish-portieri i Kosovës, Samir Ujkani, debutoi si zëvendësudrejtor i Përfaqësueses së Kosovës në sfidën me Izraelin. Një pritje e ngrohtë atij iu bë nga grupi i tifozëve "Dardanët" të cilat në tribuna shpalosën banerin duke e falënderuar atë për kontributin e dhënë. Ujkani në "Facebook" ka shkruar se debutimi si zëvendësudrejtor si dhe pritja e tifozëve i dhanë shumë

emocione atij në stolin e "dardanëve". "Mbrëmë nisa një rrugë të re në karrierën time në futboll. Për herë të parë isha në bankën e Përfaqësueses së Kosovës, jo si futbollist por në një pozicion tjetër, prandaj emocionet ishin të mëdha e të jashtëzakonshme. Mbrëmja u bë edhe më e veçantë nga nderimi që mora nga tifo-grupi ynë 'dardanët' të cilët dua t'i falënderoj

përzemërsisht. Fitorja ndaj Izraelit e bëri më të ëmbël 'debutimin' tim në një rol tjetër, prandaj do ta mbaj në mend përgjithmonë. Në fund dua që edhe njëherë t'i falënderoj të gjithë futbollistët e ekipit kombëtarë për sakrificën, angazhimin, punën dhe triumfin e përbashkët. Sfida të reja na presin të gjithëve së bashku! Përjetësisht mirënjohës", ka shkruar Ujkani.

Më 28 nëntor mbahet gara tradicionale "Vrapimi i nëntorit"

Skenderaj, 13 nëntor - Gara tashmë tradicionale "Vrapimi i nëntorit" do të mbahet edhe në këtë 28 nëntor me rastin e Ditës së Flamurit Kombëtar. Sipas organizatores së këtij aktiviteti, Valdete Qollaku,

regjistrimi është hapur për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të garojnë në këtë vrapim. "Të interesuarit mund të regjistrohen në platformën kosovapass dhe është i hapur deri më 24

nëntor", ka pohuar Qollaku. Sipas saj, vrapimi do të bëhet në dy disiplina: 28 km, që simbolizon 28 nëntorin, dhe 11 km që simbolizon muajin nëntor. "Takimi i vrapuesve do të fillojë në orën 08.00 te

kompleksi i familjes Jashari, ndërkaq vrapimi fillon në 09.30", ka shtuar ajo. Ky aktivitet është bërë tradicional, pasi që po realizohet për të tretin vit me radhë.



Etrit Berisha në formacionin e javës në Serinë A

NAPOLI, 13 NËNTOR - Ka përfunduar xhiron e 12-të në elitën e futbollit italian Serie A me disa rezultate befasese. Kampioni në fuqi i Italisë, Napoli, pësoi humbje nga Empoli 0-1 dhe toskanët e morën këtë fitore falë pritjeve

të jashtëzakonshme të portierit shqiptar Etrit Berisha. Repreruesi i Shqipërisë ka bërë disa pritje të mrekullueshme duke e mbajtur portën e paprekur dhe duke i siguruar skuadrës tre pikë. Falë pritjeve të

mrekullueshme, Berisha është lojtari me notën më të lartë në Serinë A. 34-vjeçari ka marrë notën 9,1 nga SofaScore, derisa është në 11-shen më të mirë të javës së bashku me disa yje nga elita e futbollit italian. Në mbrojtje janë

Mazzocchi i Salernitanas, Acerbi e Dimarco të Interit dhe Dossena i Cagliariarit. Ndërkohë reparti i mesfushës përbëhet nga Fazzini, Boloca, Calhanoglu dhe Kostiq. E në sulm janë dyshja Thorstvedt dhe Colpani.



Pesëshja dhe MPV-ja e javës në Superligën e Femrave

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Në fundjavë u zhvillua xhiron e gjashtë e Superligës së Femrave në Basketboll. Ndashja kryesore u zhvillua në kryeqytet. Prishtina triumfoi ndaj Pejës 03 me rezultat 66:46. Kjo ishte fitorja e dytë e Prishtinës ndaj Pejës 03 për këtë edicion. Më të dalluarat për fitoren e Prishtinës ishin Asiana Johnson dhe Jade Williams. Johnsoni pati efikasitet prej 25 pikësh, 12 kërcime dhe 6 asistime, ndërsa u ndihmua nga bashkëlojtarja Williams me 22 pikë, 13 kërcime dhe 1 asistim. Ndashje mjaft interesante u zhvillua edhe në Mitrovicë. Bashkimi fitoi me përmbysje ndaj Trepçës me rezultat 73:91. Për fitoren e Bashkimit, si zakonisht, më të mirat ishin Sarah Mgbeike dhe kapitenia Aulona Muhadri. Mgbeike kontribuoi me 29 pikë, 15 kërcime dhe 2 asistime, ndërsa Muhadri shtoi 14 pikë, 16 kërcime dhe 4 asistime.

Xhiron e gjashtë u mbyll me ndeshjen e zhvilluar në Pejë në mes të Penzës dhe United Basketballit. Vashat nga Peja



arritën fitore me shifrat 79:56. Te Penza më meritorja ishte Lexus Eagle Chasing me 21 pikë, 6 kërcime dhe 1 asistim. Asiana

Johnson është shpallur lojtarja më e mirë e kësaj jave, pasi pati efikasitet prej 25-pikësh, 12 kërcime dhe 6 asistime.

Philadelphia e pandalshme, bien Denveri dhe Golden State

PHILADELPHIA, 13 NËNTOR - Philadelphia korri fitoren e tetë radhazi, duke mundur me rezultat 137-126 Indianan dhe duke udhëhequr Konferencën e Lindjes. Ajo bëhet skuadra me rekordin më të mirë aktualisht në NBA (vetëm 1 humbje). U dallua Maxey me 50 pikë, mbështetur edhe nga Embiid me 37 pikë. Fitorja e dytë radhazi për lakersat, që mundën Portlandin (116-110), ndeshje me rivalitet. Anthony Davis me 30 pikë e 11 rebounde

REZULTATET

New York - Charlotte	129-107
Brooklyn - Washington	102-94
Clippers - Memphis	101-105
Philadelphia - Indiana	137-126
Chicago - Detroit	119-108
Houston - Denver	107-104
New Orleans - Dallas	124-136
San Antonio - Miami	113-118
Phoenix - Oklahoma	99-111
Golden State - Minnesota	110-116
Lakers - Portland	116-110



ishte shënuesi më i mirë për lakersat, që luajtën pa LeBron Jamesin. Humbet skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e clippersve, që u mund me rezultat 105-101 nga Memphis (Bane 27 pikë). Skuadra e Golden States zhgënjën në fushën e saj, duke u mundur me

shifrat 116-110 nga Minnesota. Për miqtë u dallua Edwardsi me 33 pikë, duke i bërë të pavlefshme 38 pikët e Curryt. Kampionët e Denverit u mundën me rezultat 107-104 nga Houstoni, takim ku për teksanët u dalluan VanVleet me 26 pikë e Sengun me 22.

SHKURT

Lëndohet Ajeti, ftohet Mersinaj

Federata Shqiptare e Futbollit ka njoftuar për një ndryshim në listën e Kombëtares për dy ndeshjet e fundit të kualifikueseve të "Euro 2024" ndaj Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Departamenti i Komunikimit në FShF bën me dije se mbrojtësi Arlind Ajeti nuk do të jetë i gatshëm për këto dy sfida për shkak të dëmtimit. Futbollisti është dëmtuar gjatë ndeshjes së fundit në kampionatin rumun me Cluj, por është paraqitur mbrëmë në grumbullimin e Kombëtares, duke iu nënshtruar kontrolleve mjekësore. Pas rezonancës magnetike është konkluduar se Ajeti ka një dëmtim në muskujt e pasmë të kofshës së majtë dhe ka nevojë për disa ditë pushim para se ta nisë rikuperimin. Në këto kushte trajneri Sylvinho ka vendosur të thërrasë për këto dy ndeshje mbrojtësin Jon Mersinaj, i cili do të bashkohet me ekipin në orët në vazhdim. Lojtarët e tjerë nuk kanë probleme fizike dhe i gjithë grupi pritet të plotësohet gjatë mbrëmjes së të hënës.

Tuchel: Mbappe te Bayerni? Do të shkoja ta merrja me biçikletë

Trajneri i Bayern Munchenit, Thomas Tuchel, ka thënë se është i gatshëm të shkojë ta marrë Kylian Mbappe në Paris, gjithnjë nëse sulmuesi do të pranonte t'i bashkohej klubit gjerman. "A e do transferimin e Mbappes? Po, po, ai do të luajë për ne. Kjo është e qartë (qesh). Është i pabesueshëm. Nëse dëshiron të vijë, do të shkoj ta marr me biçikletë! Por, mendoj se ky nuk është realitet", ka thënë Tuchel për "Canal Plus".

Fabregas emërohet trajner i Comos

Ish-repreruesi spanjoll Cesc Fabregas ka marrë drejtimin e skuadrës italiane Como e cila garon në Serinë B. Como vendosi ta shkarkojë trajnerin Moreno Longo, me Cesc Fabregas dhe stafin e tij që kanë marrë përkohësisht drejtimin e skuadrës. "Pas disa muajsh planifikimi strategjik, bordi i Como 1907 vendosi që ndryshimi dinamik ishte në interesin më të mirë të klubit. Longo iu bashkua Comos në shtator 2022 dhe e ndihmoi skuadrën ta shmangte rënien, duke përfunduar në vendin e 13-të sezonin e kaluar. Cesc Fabregas, i cili aktualisht drejton Primavera del Como 1907, do ta ketë seancën e parë stërvitore të mërkurën në mëngjes", thuhet në njoftimin e lëshuar nga skuadra italiane.

Pedri: Ndashje e komplikuar, pjesa e dytë për t'u duartrokitur

Barcelona mezi e mposhti Alvesin me rezultat 2-1 në La Liga. Mesfushori dhe regjisor i lojës së Barcelonës, Pedri, ka thënë ndeshja ishte mjaft e vështirë, por ai shprehur i kënaqur me pjesën e dytë, në të cilën katalanasit shënuan dy gola dhe rrëmbyen pikët e plota. "Takimi vërtet i komplikuar ndaj një kundërshtari tepër të vështirë. Pjesa e dytë na bëri më të kthjellët në manovrat e grupit. Kishim shanse dhe organizoheshim më mirë me topa nga mbrapa. Përgjatë 45 minutave të para na mungoi ritmi dhe lakmia përpara portës mike. Gjithsesi e rëndësishme fitorja dhe pikët pas kësaj periudhe të trazuar. Përmirësimi mbetet evident. Shpresoj se gjithçka do të shkojë mirë në planin përgatitor deri në testin e radhës", ka thënë Pedro.

Ten Hag beson tek Unitedi: Jemi pranë vendit të katërt

Manchester Unitedi ka fituar më shumë pikë në 5 ndeshjet e fundit në Premierë Ligë se çdo skuadër tjetër. Fitorja ndaj Lutonit e lë Manchesterin 5 pikë nga vendi i

katërt, Totenhemi, dhe trajneri Erik ten Hag thotë se skuadra e tij është në një pozicion shumë të mirë pavarësisht se këtë sezon ka pësuar 5 humbje në kampionat. Por

holandezi pranoi se "djajtë" duhet të shënojnë më shumë: "Edhe pas të gjitha pengesave me të cilat u përballëm, ne jemi ende në një pozicion afër katërshes së parë.

Edhe skuadrat e tjera do të kenë pengesa dhe do të humbasin pikë. Tani ne kemi fituar katër ndeshjet tona të fundit nga pesë në Premierë Ligë, që është pozitive. Ne jemi në

fakt në një pozitë mjaft të mirë, nëse i shikoni të gjitha problemet që kemi pasur. Por mund t'ia bëjmë më të lehtë vetes jetën duke shënuar më shumë".



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Tomor Toçani shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 6-9 të shkollës fillore "Asim Vokshi" Prishtinë.

- N.T.P. " Al&Doni" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810525347, Kujtim Gërbeshi B.I.

- Mehdi Kastrati shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Medresesë Alaudin Prishtinë.

- Bedrush Nezaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "Nexhmedin Nixha".

- Aulona Ramaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Kastriot Xhema shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Hasan Prishtina.

- Hajdar Sylejmani shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Fidan Hoti shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".

- Gezim Sadiku, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "ISMAIL QEMALI".

- Muhamet Veseli, shpall të pavlefshme dëftesat e vitit I,II,III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme "ARKITEKT SINANI".

- Muhamet Preteni, shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPÇA", STANTERG.

- Shaban Bunjaku B.I, shpall të pavlefshme arkën fiskale PEF me numër: DG06600094, nr-biznesit: 811543687.

- Gjeral Ukaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Korishit " Korishe.

- Alore Magi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Tomë Marku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Dëshmorët Lleshi".

- Halil Rugova nga Istogi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike " Nexhmedin Nixha".

- Donart Ibrahim shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Lulzim Musa shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- "Idea A" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811447996.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

